



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR
PUSHTETIN VENDOR

RAPORT VJETOR

AGJENCIA PËR MBESHTETJETEN
E VETËQEVERISJES VENDORE

JANAR - DHJETOR 2025

agjencia për mbështetjen



e vetëqeverisjes vendore

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	1
LISTA E FIGURAVE	2
LISTA E TABELAVE.....	2
AKRONIMET.....	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
STRUKTURA	6
KAPITULLI 1: DREJTORIA E KUADRIT RREGULLATOR DHE DECENTRALIZIMIT 8	
1 Kuadri rregullator.....	8
1.1 Hartimi i vendimeve tip te Këshillit Bashkiak, urdhreve tip të Kryetarit të Bashkisë dhe draft rregulloreve.....	8
1.2 Ligji për “Administrimin e Bashkëprojesisë në Ndërtesa”	8
1.3 Ligji për “Shoqëritë Publike Vendore”	8
1.4 Ligji “Për Paketën e Maleve”.....	8
1.5 Ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.	9
2 Decentralizimi horizontal	9
2.1 Fusha e Arsimit	9
2.2 Fusha e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.....	11
2.3 Fusha e Kujdesit Shëndetësor Parësor	11
3 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore	12
KAPITULLI II: DREJTORIA E TRAJNIMIT DHE FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE .. 13	
1 Këshilli konsultativ qeveri qendrore - vetëqeverisje vendore	13
2 Monitorimi i Planeve të Integritetit dhe asistencë ndaj bashkive për hartimin e planeve të reja 15	
2.1 Monitorimi i Planeve të Integritetit.....	15
2.2 Aktivitete Mbështëse	16
3 Zhvillimi i kapaciteteve dhe organizimi i trajnimeve teknike.....	16
4 Hartimi i kurrikulave dhe moduleve profesionale	17
5 Akademia e trajnimit të NjVV-ve (TALGA)	17
KAPITULLI III : DREJTORIA E STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS	18
1 Faqja zyrtare e internetit: qeverisjavendore.gov.al	18
2 Sistemi i Matjes së Performancës.....	19
3 Granti i Bazuar në Performancë.....	21

4	Projekti “Open Dat’ Alb”	23
	KAPITULLI IV: DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE	24
1	Zhvillimet lidhur me Kapitullin 22.....	24
2	Informimi, përgatitja dhe fuqizimi i drejtpërdrejtë i bashkive mbi procesin e integrimit evropian	25
3	Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të Njesive të Integrimit Evropian nëpërmjet trajnimeve.....	26
4	Realizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me projektet e asistencës teknike të BE-së në fushën e Integrimit Evropian.....	27
4.1	Bashkëpunimi me Projektin EU4GoodGovernance	27
4.2	Bashkëpunimi me Programin ReLoaD 3	28
	KAPITULLI V: MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AMVV DHE UNIVERSITETIT TË TIRANËS	29

LISTA E FIGURAVE

Figura 1.	Struktura e përgjithshme AMVV	7
Figura 2.	Prurjet e projektakteve për konsultim në Këshillin Konsultativ 2025	14
Figura 3.	Pjesmarrja e forumit qeveri qendrore – vendore në takimet e Këshillit Konsultativ 2025.....	14
Figura 4.	Faqja zyrtare e internetit ‘qeverisjavendore.gov.al’	19
Figura 5.	Pjesëmarrja e stafit të bashkive në trajnime	21

LISTA E TABELAVE

Tabela 1.	Trajnimet e ofruara për periudhën janar – dhjetor 2025	26
------------------	---	-----------

AKRONIMET

AFD	Agjencia Franceze për Zhvillim
AFMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Financiar në Shqipëri
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BE	Bashkimi Evropian
BNJ	Bashkëpunimi Ndërbashkiak
BtF	Bashki të Forta
CERV	Programi Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EEAS	Shërbimi i Veprimit të Jashtëm të Bashkimit Evropian
GBP	Granti i Bazuar në Performancë
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
GNP	Grupi Ndëristitucional i Punës
IDM	Instituti për Demokracinë dhe Ndërmjetësimin
IE	Integrimi Evropian
IPA	Instrument i Paraantarësimit
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
KE	Këshilli Evropian
KK	Këshilli Konsulativ
MF	Ministria e Financave
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
OJF	Organizata Jofitimprurëse
PI	Plan Integriteti
PRAG	Udhëzues Praktik për Prokurimin dhe Dhënien e Granteve
PV	Plan Veprimi
QQ	Qeveria Qendrore
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SECO	Sekretariati i Shtetit për Çështje Ekonomike
SHKBSH	Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë
SHKQSH	Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë
SMP	Sistemi i Matjes së Performancës

SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
TAIEX	Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian
KE	Komisionit Evropian
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UT	Universiteti i Tiranës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit raportues, Angjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore mbështeti **forcimin e bazës ligjore dhe institucionale të vetëqeverisjes vendore** përmes hartimit dhe përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore dhe ofrimit të asistencës juridike për bashkitë. U mbështet **standardizimi i praktikave administrative** dhe avancimi i reformave të decentralizimit, përfshirë pilotimin e **decentralizimit horizontal** në sektorët e arsimit, bujqësisë dhe kujdesit shëndetësor parësor. Gjithashtu, u realizua monitorimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, duke evidentuar progresin dhe sfidat e zbatimit të saj.

AMVV kontribui në forcimin e qeverisjes vendore përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe promovimit të integritetit institucional. Nëpërmjet rolit të saj në **Këshillin Konsultativ** u siguria dialog i strukturuar ndërinstitutional për konsultimin e akteve që prekin pushtetin vendor. U mbështet hartimi dhe monitorimi i Planeve të Integritetit, u organizuan trajnime teknike për administratën vendore dhe u hartuan kurrikula profesionale, ndërsa krijimi i **Akademisë së Trajnimit të NJVV-ve (TALGA)** shënoi institucionalizimin e sistemit të trajnimit për pushtetin vendor.

AMVV përmes zhvillimit të instrumenteve të monitorimit dhe analizës së performancës vendore forcoi transparencën dhe vendimmarrjen e bazuar në të dhëna. Faqja zyrtare e web u konsolidua si platformë kryesore informimi dhe asistence për bashkitë, ndërsa **Sistemi i Matjes së Performancës (SMP)** u institucionalizua në të 61 bashkitë, duke standardizuar treguesit dhe duke lidhur rezultatet me mekanizmin e **Grantit të Bazuar në Performancë (GBP)**. GBP 2025 si një mekanizëm financiar arriti **të shpërblente të gjitha bashkitë** sipas skemës së vlerësimit, duke përmbushur vizionin politik të saj, bashki më konkurruese, transparente dhe llogaridhenese. Paralelisht, projekti Open Dat'Al avancoi drejt dizentimit të një platforme të dhënash të hapura për mbështetjen e politikëbërjes vendore.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian AMVV ka mbështetur rritjen e rolit të pushtetit vendor, veçanërisht në kuadër **të negociatave për Kapitullin 22**. AMVV koordinoi proceset ndërinstitutionale, kontribui në përgatitjen e dokumenteve negociuese dhe forcoi kapacitetet e bashkive përmes trajnimeve dhe asistencës për akses në fondet e BE-së. Aktivitetet e zhvilluara dhe bashkëpunimi me projektet e asistencës teknike ndihmuan përmirësimin e përgatitjes institucionale të bashkive sipas standardeve evropiane.

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet AMVV dhe Universitetit të Tiranës, u realizuan studime dhe analiza që mbështesin zhvillimin strategjik të qeverisjes vendore. Bashkëpunimi përfshiu hartimin **e strategjisë së zhvillimit ekonomik për Qarkun Elbasan dhe planeve zhvillimore 5-vjeçare për bashkitë**, si dhe **hartëzimin e vendimeve tip të këshillave bashkiakë** për unifikimin e praktikave administrative. Gjithashtu, u realizua një **analizë historike mbi evolucionin e qeverisjes vendore në Shqipëri**, duke ofruar bazë analitike për politikat aktuale të decentralizimit.

STRUKTURA

AMVV, që në krijimin e saj ka pasur një mandat të qartë në funksion të mbështetjes së 61 bashkive të reja të krijuara pas miratimit të reformës administrativo-territoriale. Me thellimin e reformës së decentralizimit dhe procesit të integritetit evropian, ky mandat është zgjeruar me një numër funksionesh dhe kompetencash të reja. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2024, AMVV ka rritur kapacitetet e saj, me qëllim që të përmirësojë dhe rrisë aftësinë e saj për të kryer me efikasitet funksionet dhe detyrat aktuale duke i paraprirë detyrave dhe sfidave të shtuara të proceseve integruese në të ardhmen e afërt.

Struktura aktuale dhe organigrama e AMVV janë përcaktuar me Urdhër të Kryeministrit nr.83, datë 20.05.2024 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”. Për vitin 2024, organigrama dhe struktura e AMVV kanë ndryshuar duke kaluar në 8 sektorë, 4 drejtori dhe një sektor për financën dhe shërbimet mbështetëse. Sipas këtij ndryshimi, numri i punonjësve të AMVV shkon në 32, nga 22 punonjës, që përfshiheshin në strukturën e vitit 2023. Struktura e agjencisë paraqitet si më poshtë:

I. Drejtoria e Kuadrit Rregullator dhe Decentralizimit

1. Sektori i Kuadrit Ligjor
2. Sektori i Decentralizimit

II. Drejtoria e Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve

1. Sektori i Vlerësimit të Nevojave dhe Hartimit të Kurrikulave
2. Sektori i Trajnimeve dhe Konsultimeve

III. Drejtoria e Statistikave dhe Performancës

1. Sektori i Statistikës
2. Sektori i Performancës

IV. Drejtoria e Integritetit Evropian dhe Projekteve

1. Sektori i Integritetit Evropian
2. Sektori i Projekteve

V. Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse




Figura 1. Struktura e përgjithshme AMVV

Aktualisht, marrëdhëniet e punës në Agjenci rregullohen nga Kodi i Punës. Kriteret specifike dhe procedurat e rekrutimit zbatohen sipas legjislacionit në fuqi dhe janë të përcaktuara gjithashtu në rregulloren e brendshme të AMVV-së, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor. Në vijim të ndryshimeve në strukturën dhe organikën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore sipas Urdhërit të Kryeministrit nr. 83, datë 20.05.2024, u bë e domosdoshme përmirësimi dhe përditësimi i kuadrit të brendshëm rregullator të AMVV-së. Në këtë drejtim, është përfunduar rregullorja e re e brendshme e AMVV.

KAPITULLI 1: DREJTORIA E KUADRIT RREGULLATOR DHE DECENTRALIZIMIT

1 Kuadri rregullator

Gjatë periudhës raportuese, u realizua një angazhim i gjerë profesional në hartimin, përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e vetëqeverisjes vendore, si dhe në ofrimin e asistencës teknike dhe ligjore për bashkitë dhe institucionet qendrore.

1.1 Hartimi i vendimeve tip të Këshillit Bashkiak, urdhrave tip të Kryetarit të Bashkisë dhe draft rregulloreve

Në veçanti, u hartuan 66 vendime tip të Këshillit Bashkiak, 4 urdhra tip të Kryetarit të Bashkisë dhe 6 rregullore model, që synojnë standardizimin e praktikave vendore dhe rritjen e transparencës e integritetit institucional. Gjithashtu, u përgatit Rregullorja e Brendshme e AMVV-së, duke forcuar rregullat e funksionimit dhe etikës institucionale.

1.2 Ligji për “Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesa”

Një vëmendje e veçantë iu kushtua procesit të hartimit të draft-ligjit për Shoqëritë Publike Vendore, përmes përgatitjes së dokumentit analitik me rekomandime, koordinimit të Grupit Ndërinstitucional të Punës, si dhe grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave nga bashkitë mbi ndërmarrjet publike vendore.

1.3 Ligji për “Shoqëritë Publike Vendore”

Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 55/2025 për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa, u hartua ëhite paper-i analitik, draft-rregullorja për administrimin e ndërtesave dhe banesave, raporti për konsultim publik dhe materiale shpjeguese për institucionet zbatuese.

1.4 Ligji “Për Paketën e Maleve”

Në zbatim të ligjit për Paketën e Maleve, u hartuan projekt-udhëzime dhe materiale shpjeguese, si dhe u ofrua asistencë e drejtpërdrejtë teknike dhe ligjore për disa bashki Tiranë, Mat, Kuçovë, Elbasan, përfshirë përgatitjen e procesverbaleve, hartave dhe dokumentacionit të aplikimit. Po ashtu, u përgatitën draft-VKM dhe relacionet për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit për disa bashki.

1.5 Ligji nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

Kontributi institucional u shtri edhe në procesin e hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin”, si dhe në procesin e rishikimit të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ku u mor pjesë aktive në punën e Grupit të Punës dhe u hartuan projekt-vendime dhe materiale mbështetëse, përfshirë ato për Policinë Bashkiake dhe IMT-në.

Gjithashtu, u ndoqën dhe u trajtuan çështje gjyqësore ku AMVV ishte palë, përmes përgatitjes së prapësimeve me shkrim, memo-ve informuese dhe koordinimit me Avokaturën e Shtetit për ndjekjen e çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Ky angazhim ka kontribuar drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve ligjore dhe institucionale të vetëqeverisjes vendore, rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe mbështetjen e reformave kyçe në nivel vendor.

2 Decentralizimi horizontal

Në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 81, datë 15.5.2024 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e mekanizmit pilot “decentralizim horizontal”, që lidhet me ushtrimin e funksioneve të përbashkëta në fushën e arsimit, midis pushtetit qendror dhe vendor, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor koordinon grupin ndërinstitucional të punës me përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë, Bujqësisë, Arsimit si dhe nga Bashkitë Kolonjë, Shkodër, Berat dhe Divjakë.

Marrëveshjet midis Ministrive dhe bashkive janë firmosur në muajin nëntor 2024.

Ecuria e procesit të mekanizmit pilot në të tre fushat përkatëse paraqitet si më poshtë:

2.1 Fusha e Arsimit

Ministria e Arsimit dhe bashkitë Divjakë, Berat, Shkodër, Kolonjë janë angazhuar të zbatojnë ushtrimin e përgjegjësisë me synim përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e cilësisë në arsim duke u bazuar në nenin 13 të Kushtetutës, nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 26 dhe 27 të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Në përputhje me dispozitat ligjore të cituara më sipër, marrëveshja ka patur si synim rritjen e cilësisë në arsim në lidhje me:

- a. Procedurat e emërimit të punonjësve arsimorë në institucionet publike të arsimit parauniversitar në territorin nën juridiksionin të bashkisë, për pozicionet drejtuese në nivel shkolle si dhe stafin mësimor në nivel shkolle.
- b. Riorganizimin e Bordeve, përbërjes së tyre, mënyrës së funksionimit dhe organizimit të shkollave nën juridiksion të bashkisë, duke përfshirë më shumë anëtarë në këto borde nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

- c. Hartimin dhe zbatimin e planit për optimizimin/rajonalizimin e shkollave me synim uljen e numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive.
- d. Ngritjen e Bordit Koordinues dhe caktimin e koordinatorëve në zbatim të marrëveshjes.
- e. Krijimin e kushteve për nxitjen e autonomisë financiare të institucioneve arsimore publike në territorin në juridiksionin e Bashkisë për menaxhimin nga Bordet të të ardhurave të krijuara prej tyre.
- f. Sigurimin e transportit për nxënësit dhe mësuesit sipas kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve AMVV ka komunikuar me bashkitë dhe me ministritë të përfshira në marrëveshje, me qëllim caktimin e pikave të kontaktit për çdo fushë dhe fillimin e procesit.

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore ka ndjekur procesin e punës dhe ka patur një rol proaktiv, në nxitjen për zbatimin të marrëveshjes duke organizuar dhe **zhvilluar takimet në 4 bashkitë** dhe mbledhur aktorët e caktuar për zbatimin e marrëveshjes.

1. Takimi në Bashkinë Shkodër, me përfaqësuesit e Bashkisë, MSHPV-së dhe Ministrisë së Arsimit, Zyrës Vendore Arsimore Shkodër dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë.
2. Takimi në Bashkinë Berat, me përfaqësuesit e Bashkisë MSHPV-së dhe Ministrinë e Arsimit, Zyrës Vendore Arsimore Berat si dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë.
3. Takimi në Bashkinë Divjakë, me përfaqësuesit e Bashkisë, MSHPV-së dhe Ministrinë e Arsimit dhe Zyrës Vendore Arsimore Divjakë.
4. Takimi në Bashkinë Kolonjë me përfaqësuesit e Bashkisë, MSHPV-së, Ministrinë e Arsimit dhe Zyrës Vendore Arsimore Kolonjë dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë.

Në këtë kuadër ka patur një avancim të decentralizimit në procedurën e emërimit të punonjësve arsimorë, nëpërmjet ndyshimit të udhëzimit dhe përfshirjen e përfaqësuesit nga bashkia në komision.

Gjithashtu ndryshimet dhe shtesat në udhëzimin për funksionimin e bordeve të institucionit arsimor, duke përfshirë përfaqësuesin nga ana e bashkisë, kanë lehtësuar punën për funksionimin e këtyre bordeve.

Në përfundim të marrëveshjes, mbetet sfida zbatimi i Planit vjetor të qendërimit të shkollave, duke sjellë uljen e numrit të nxënësve që mësojnë në klasa kolektive, pasi do të sillte pasoja për punësimin e mësuesve. Gjithashtu nxitja e autonomisë financiare të institucioneve arsimore publike për menaxhimin nga bordet dhe menaxhimi i të ardhurave nga këto borde, për shkak të koordinimit dhe grumbullit të të ardhurave të bordit.

2.2 Fusha e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në Korçë, Berat dhe Shkodër, si dhe bashkitë Divjakë, Berat, Shkodër dhe Kolonjë, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për transferimin e disa përgjegjësisve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me qëllim forcimin e procesit të decentralizimit.

Marrëveshja u hartua bazuar në nenet 13, 112, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 9 pika 1.1, germa “c”, 10, 11, dhe 27 të Ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, i ndryshuar. Vendimi Nr. 147, datë 13.03.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes nga palët, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ka bashkërenduar punën me bashkitë dhe me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) për përcaktimin e pikave të kontaktit dhe krijimin e bordit koordinues ndërmjet palëve.

Sa më sipër lista e kontakteve me përfaqësuesit e bashkive është dorëzuar pranë MBZHR-së, po nuk ka patuar avancime të mëtejshme në zbatimin të marrëveshjes edhe pse kërkesat për bashkëpunim dhe vijimin e punës në zbatim të saj, kanë qenë të vazhdueshme nga AMVV.

Si rrjedhojë, kjo fushë nuk ka patur asnjë avancim të decentralizimit apo zbatim të marrëveshjes të sipërpërmendur.

2.3 Fusha e Kujdesit Shëndetësor Parësor

Në kuadër të pilotimit të decentralizimit të funksioneve në kujdesin shëndetësor parësor, me nënshkrimin e marrëveshjes midis Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor dhe bashkive pilot, vijoi procesit i monitorimit të zbatimit të marrëveshjes.

Disa nga objektivat e marrëveshjes për ushtrimin e përgjegjësisve të përbashkëta ishin:

- a. Përfshirja e një përfaqësuesi të bashkisë në emërimin e drejtuesit të institucionit shëndetësor të kujdesit parësor.
- b. Bashkëpunimi dhe koordinimi i MSHMS-së me bashkitë për standartet e ndërtimit të godinave shëndetësore dhe nevojave të popullsisë.
- c. Hartimi i standarteve për furnizimin me barna të qendrave shëndetësore.

Në zbatim të marrëveshjes, janë zhvilluar dy takime, në Bashkinë Divjakë dhe Berat, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkisë, AMVV-së, MSHMS-së, FSKDSH-së, dhe NJVKSH-ve përkatëse. Takimet u fokusuan në ecurinë e zbatimit të objektivave, duke theksuar nevojën për bashkëpunim të strukturuar në administrimin e godinave dhe koordinimin e investimeve në qendrat shëndetësore në territorin e bashkisë.

3 Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 227, datë 9.4.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore”, është përgatitur raporti i monitorimit për vitin 2023, të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2023-2025.

Raporti i publikuar gjatë vitit 2024, paraqet vitin e parë të raportimit mbi ecurinë dhe zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të veprimit. Gjatë procesit për grumbullimin e të dhënave për raportin, janë zhvilluar dy ëorkshope, me institucionet qendrore dhe ato vendore, përgjegjëse për zbatimin e masave/aktiviteteve sipas planit të veprimit, me fokus informimin në lidhje me procesin e raportimit, për 17 institucione qendrore dhe 61 bashki. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik 2024, paraqet ecurinë e zbatimit të masave për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2023.

Nga një vështrim i përgjithshëm, nga 158 masa të parashikuara për vitin 2023, vërejmë se 35 masa janë zbatuar në nivelin 100%, 46 masa janë zbatuar në nivelin 51%-99%, 51 masa janë në proces realizimi dhe për 26 masa nuk ka filluar ende zbatimi ose përqindja e zbatimit është shumë e ulët.

Për sa i përket 6 qëllimeve politike kanë patur një ecuri të tillë ku, qëllimi politik nr.1 në zbatimin total të masave shënon rezultatin prej 51%, qëllimi nr.2 shënon një nivel realizimi prej 53%, qëllimi nr.3 nivel realizimi prej 60%, qëllimi nr.4 nivel realizimi prej 43%, qëllimi politik nr.5 nivel realizimi prej 66%, ndërsa qëllimi politik nr.6 shënon rezultat më të dobët me 30% krahasuar me qëllimet e tjera për sa i përket zbatimit të masave.

KAPITULLI II: DREJTORIA E TRAJNIMIT DHE FUQIZIMIT TË KAPACITETEVE

1 Këshilli konsultativ qeveri qendrore - vetëqeverisje vendore

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Këshilli Konsultativ ka vepruar si një forum kolegjal i rëndësishëm në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, bazuar në VKM Nr. 244, datë 17.4.2024. Ky mekanizëm ka siguruar një platformë dialogu për hartimin e politikave publike dhe legjislacionit që prekin njësitet e vetëqeverisjes vendore.

Këshilli udhëhiqet nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo, në bashkëkryesim me z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë. Ky forum përbëhet nga 22 anëtarë, me përfaqësim të barabartë mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke u fokusuar në konsultimin e projektakteve dhe strategjive që ndikojnë në kompetencat vendore.

Përgjatë këtij viti janë zhvilluar **9 mbledhje**, ku janë marrë në shqyrtim **41 projektakte** të sjella nga ministritë e linjës dhe propozime nga bashkitë Lushnje dhe Kamëz.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2025, Këshilli Konsultativ ka funksionuar si një forum kolegjal kyç për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, bazuar në VKM Nr. 244, datë 17.4.2024. Ky mekanizëm ka garantuar një platformë të qëndrueshme dialogu për hartimin e politikave publike dhe legjislacionit që prekin drejtpërdrejt njësitet e vetëqeverisjes vendore. Këshilli drejtohet nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, z. Ervin Demo, në bashkëkryesim me z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë. Forumi përbëhet nga 22 anëtarë me përfaqësim të barabartë (11 me 11) mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke u fokusuar në konsultimin e projektakteve dhe strategjive që ndikojnë në kompetencat vendore.

Përgjatë këtij viti janë zhvilluar 9 mbledhje, ku janë marrë në shqyrtim gjithsej 49 akte dhe dokumente. Prej tyre, 29 projektvendime, 9 projektligje, 6 draft-dokumente ose raportime me karakter informues dhe strategjik, si dhe 2 projektudhëzime. Një element i rëndësishëm ishin 2 propozimet e ardhura drejtpërdrejt nga Bashkia Lushnje dhe Bashkia Kamëz për ndryshimin dhe krijimin e akteve të reja.




Figura 2. Prurjet e projekteve për konsultim në Këshillin Konsultativ 2025




Figura 3. Pjesmarrja e forumit qeveri qendrore – vendore në takimet e Këshillit Konsultativ 2025

Nga pushteti qendror kanë marrë pjesë mesatarisht 50% e anëtarësisë së këshillit në raport me 11 anëtarë, ndërsa nga pushteti vendor kanë marrë pjesë mesatarisht 27% e anëtarësisë së këshillit konsultativ në raport me 11 anëtarë. Bashkitë përfaqësohen nga Kryetari i bashkisë ose nga Zëvendëskryetari, Drejtori i Drejtorisë përkatëse, Sekretari i Përgjithshëm ose Drejtor Kabineti i bashkisë si dhe specialistë sipas drejtorive përkatëse, ndërsa pushteti qendror përfaqësohet nga zëvendësministri i linjës në shumicën e rasteve ose në mungesë të tij nga drejtor institucioni sipas fushës përkatëse të akteve që konsultohen në mbledhjen përkatëse.

2 Monitorimi i Planeve të Integritetit dhe asistenca ndaj bashkive për hartimin e planeve të reja

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), gjatë vitit 2025, nëpërmjet Drejtorisë së Trajnimit dhe Fuqizimit të Kapaciteteve, ka trajtuar me prioritet forcimin e integritetit institucional dhe luftën kundër korrupsionit në nivel vendor. Ky angazhim ka dhënë rezultate konkrete në harmonizim me politikat e Qeverisë Shqiptare kundër korrupsionit. Puna është fokusuar në tre drejtime kryesore: asistenca për hartimin e planeve, monitorimi i zbatimit të tyre dhe rritja e transparencës vendore.

Deri në fund të vitit 2025, procesi i hartimit dhe miratimit të Planeve të Integritetit ka dhënë rezultate positive, duke rezultuar **44 bashki** me këtë instrument strategjik parandalues kundër korrupsionit i nxitur edhe nga mekanizmi i Grantit Bazuar në Performancë 2025.

Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha bashkitë janë asistuar drejtpërdrejt nga AMVV në krijimin e bazës së dokumentave të nevojshëm për hartimin e planeve të Integritetit, në mbështetje edhe të mekanizmit të Grantit të Bazuar në Performancë. Lista e bashkiva me plane të miratuara për vitin 2025 përfshin një shtrirje të gjerë gjeografike, nga bashkitë e mëdha, të mesme dhe të vogla.

Vlen të theksojmë se ky proces ka vijuar me ritme intensive për asy të përfitimit nga Granti i Performancës, ku **11 bashki u mobilizuan dhe hartuan Plane të reja Integriteti, 8 Bashki kanë ribënë planet për herë të dytë, 7 bashki rishikuan planet e integritetit ekzistuese** duke shtuar elemente shtesë dhe **4 bashki vijnë me zbatimin e planeve ekzistuese** gjatë vitit 2025.

2.1 Monitorimi i Planeve të Integritetit

Gjatë vitit 2025 u hartua Raporti i Monitorimit për Zbatimin e Planeve të Veprimit në 17 bashki lidhur me masat e planifikuara për vitin 2024, i mbështetur në Metodologjinë e Monitorimit të Planeve të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore.

Nga monitorimi i Zbatimit të Planeve të Veprimit rezultoi se vlerësimi i korelacionit mes shkallës së zbatueshmërisë dhe indeksit të impaktit të Planit të Integritetit tregon se ka një përmirësim në aspekte të integritetit institucional dhe rritje me **1 përqind** të shkallës së zbatueshmërisë së plotë të Planit të Integritetit për vitin 2024 në krahasim me vitin paraardhës 2023. Lidhja pozitive mes zbatueshmërisë së masave të Planit të Integritetit dhe impaktit në forcimin e kulturës pro-integritet të institucioneve të pushtetit vendor, konfirmon edhe njëherë se pëpjekjet për të marrë masa parandaluese anti-korrupsion sjellin ndryshime pozitive në forcimin e integritetit në nivel vendor.

2.2 Aktivitete Mbështëse

- Zhvilluar trajnimi mbi metodologjinë e hartimit të Planeve të Integritetit, në bashkëpunim me MAPA me mbështetjen e projektit EU4GoodGovernance, në kuadër të Grantit të Bazuar në Performancë dhe Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit.
- Organizuar në datë fokus grupi on line me bashkitë Tiranë, Patos, Kolonjë, Gramsh, Pogradec, Bulqizë, ku në fokus qe diskutimi mbi rezultatet e pyetsorit të dërguar ndikimi i tij në procesin e hartimit të një metodologjie të re.
- Organizuar takimi me fokus mbi planifikimin e integritetit vendor dhe ndikimin e granteve të bazuara në performancë.

3 Zhvillimi i kapaciteteve dhe organizimi i trajnimeve teknike

Gjatë vitit 2025 u zhvilluan një sërë aktivitete trajnuese, të cilat synuan profesionalizimin e stafit të njësive të vetëqeverisjes vendore në fusha kritike si financat, migracioni dhe menaxhimi i mbetjeve.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua drejtuesve financiarë të NJVV-ve. Trajnimet e zhvilluara në Tiranë, Fier dhe Gjirokastrë, si dhe në formatin online, adresuan rolin e raportimit dhe analizës financiare në rritjen e cilësisë së vendimmarrjes. Në këto sesione morën pjesë 73 përfaqësues, duke krijuar një rrjet profesionistësh të aftë për të rritur transparencën buxhetore.

Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), u arrit realizimi me trajnime në 58 bashkive për Procedurat Standarde të Veprimit (SOP) dhe për diasporën dhe migracionin e brendshëm për motive punësimi. Pjesëmarrja prej 105 personash dëshmon rëndësinë e këtij procesi për trajtimin e dinamikave demografike në nivel vendor. Konkretisht, 41 bashki u trajnuan për SOP-në e diasporës dhe 36 bashki për migracionin e brendshëm.

Sipas të dhënave operacionale, organizimi i trajnimeve u shtri përgjatë gjithë vitit. Trajnimi për migracionin e brendshëm u realizua në periudhën mars-qershor 2025, duke përfshirë 95% të bashkive.

Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, trajnimet u zhvilluan nga tetori në dhjetor 2025. Në këtë cikël morën pjesë 38 bashki (62% e totalit), me një total prej 119 pjesëmarrësish. Është për t'u përsëritur fakti që 46 prej të trajnuarve ishin gra dhe vajza, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse në këtë sektor teknik.

4 Hartimi i kurrikulave dhe moduleve profesionale

Për të garantuar qëndrueshmërinë e njohurive, AMVV u angazhua në hartimin e 7 kurrikulave të reja me mbështetjen e BtF–Helvetas. Këto kurrikula u ndanë në dy kategori:

1. **Kurrikula sektoriale:** Duke mbuluar arsimin parashkollor, menaxhimin e mbetjeve, pyjet/kullotat dhe ujitjen/kullimin;
2. **Kurrikula për Këshillat Bashkiakë:** Me fokus në planifikimin buxhetor, zhvillimin ekonomik dhe mbikëqyrjen e shërbimeve.

Gjatë vitit 2025, u arrit 100% hartimi dhe miratimi i kurrikulës së Menaxhimit të Mbetjeve dhe tri moduleve për Këshillin Bashkiak. U finalizua moduli për Planet e Përgjithshme Vendore (PPV) në funksion të Këshillave Bashkiakë, i realizuar në bashkëpunim me OSCE. Kjo bazë kurrikulare shërben si fundament për edukimin e vazhdueshëm të të zgjedhurve vendorë dhe administratës.

5 Akademia e trajnimit të NJVV-ve (TALGA)

Viti 2025 shënoi hedhjen e bazave ligjore dhe operationale për projektin madhor të Akademisë së Trajnimit të NJVV-ve (TALGA). Ky proces kulmoi me miratimin e VKM nr. 405, datë 16.07.2025. Gjatë kësaj periudhe u realizuan:

1. Hartimi i Statutit dhe Aktit të Themelimit;
2. Miratimi i paketës së dokumenteve nga Këshillat Bashkiakë dhe Këshillat e Qarku;
3. Nënshkrimi i marrëveshjes tip për krijimin e Akademisë dhe depozitimi i dokumenteve për regjistrim;
4. Mbledhja e anëtarëve të Asamblesë dhe miratimi i dokumentave themelues;
5. Regjistrimi i Akademisë së Trajnimit të NJVV-ve (TALGA) me Vendimin Nr. 7671, datë 29.12.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Regjistrimi dhe fillimi i aktivitetit të TALGA-s përfaqëson një hap të rëndësishëm për AMVV-në, duke e shndërruar trajnimin e pushtetit vendor në një proces të institucionalizuar dhe të certifikuar sipas standardeve më të mira.

KAPITULLI III : DREJTORIA E STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

1 Faqja zyrtare e internetit: qeverisjavendore.gov.al

Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, publikon në faqen zyrtare të internetit: qeverisjavendore.gov.al, të gjithë aktivitetin e saj institucional, si dhe dokumentacionin mbështetës për pushtetin vendor, duke garantuar transparencë dhe duke përmbushur funksionin e saj themelor që lidhet me asistimin e bashkive.

Gjatë vitit raportues, AMVV ka vijuar të sigurojë funksionimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të faqes së internetit, e cila shërben si platformë qendrore e komunikimit institucional dhe e informimit publik për çështje që lidhen me qeverisjen vendore. Përmes kësaj faqeje janë vënë në dispozicion një sërë materialesh dhe dokumentesh të rëndësishme për bashkitë dhe publikun e gjerë, përfshirë:

- Dokumentacionin e mbledhjeve të njëpasnjëshme të **Këshillit Konsultativ**, të organizuar sipas muajve të zhvillimit, duke mundësuar arkivim sistematik dhe akses të plotë në procesverbalet, vendimet dhe materialet përkatëse.
- **Vendet vakante** në institucionet e qeverisjes vendore, duke rritur transparencën dhe aksesin në mundësitë e punësimit.
- **Paketën e dokumentacionit ligjor** në asistencë për bashkitë, përfshirë paketën e maleve dhe dokumentacionin mbi administrimin e bashkëpronësisë - një nismë me rëndësi të veçantë për menaxhimin e territorit dhe pasurive.
- **Raportin e Strategjisë Ndërsektoriale** dhe dokumente të tjera strategjike që ndihmojnë njësitë vendore të orientohen drejt objektivave kombëtare të zhvillimit.
- **Planet e reja të monitorimit të integritetit**, të cilat kontribuojnë në forcimin e standardeve të qeverisjes së mirë në nivel vendor.
- Informacione ndihmuese, për aplikimin në **Grantin e Bazuar në Performancë**, si dhe publikimin e rezultateve të **Raportit të Sistemit të Matjes së Performancës**, duke siguruar transparencë mbi vlerësimin e bashkive.
- **Thirrjet e hapura për aplikim** në projekte të ndryshme të dedikuara për qeverisjen vendore, duke informuar bashkitë për mundësitë e reja të financimit dhe bashkëpunimit.
- **Kalendari i trajnimeve** për fuqizimin e kapaciteteve të bashkive, i publikuar rregullisht, që u mundëson njësitë vendore të planifikojnë pjesëmarrjen në programe formimi profesional.

Këto veprimtari e kanë konsoliduar portalin si një burim informacioni të plotë, të strukturuar dhe të besueshëm, duke rritur transparencën institucionale dhe duke mbështetur drejtpërdrejt bashkitë në përmbushjen e funksioneve të tyre.




Figura 4. Faqja zyrtare e internetit 'qeverisjavendore.gov.al'

2 Sistemi i Matjes së Performancës

Sistemi i Matjes së Performancës (SMP) zbatohet në 61 bashkitë e vendit dhe përbën mekanizimin kryesor kombëtar për vlerësimin e funksionimit të Vetëqeverisjes Vendore. Ai ofron një panoramë gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme mbi menaxhimin e financave vendore, cilësinë e ofrimit të shërbimeve të decentralizuara dhe funksionimin e mekanizmave të mirëqeverisjes. Në thelb, SMP synon të forcojë transparencën dhe llogaridhënien, duke krijuar një bazë të standardizuar të të dhënave, që mbështet vendimmarrjen e informuar dhe përmirësimin e qeverisjes lokale në fushat: *Performanca Financiare, Arsimi parashkollor, Ujitja dhe kullimi, Pyjet dhe kullotat, Mbrojtja nga zjarri, Menaxhimi i mbetjeve, Shërbimet sociale, Burimet njerëzore, Transparenca, Barazia gjinore dhe Integrimi Evropian*

Standardet e shërbimeve vendore, performanca e tyre dhe përcaktimi i nivelit minimal të ofrimit përcaktohen qartësisht në nenin 33, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe përforcohen më tej në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030. Në këtë kuadër, me Urdhrin nr. 213, datë 13.12.2023, të Kryeministrit, u ngrit Grupi Ndërinstitucional i Punës (GNP), i ngarkuar me hartimin e propozimeve ligjore dhe institucionalizimin e procesit të matjes së performancës së shërbimeve publike vendore. Mbështetja teknike dhe organizative e këtij grupi sigurohet nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), e cila kryen funksionin e sekretariatit teknik.

Gjatë vitit raportues, fokusi kryesor i institucionit ka qenë forcimi, unifikimi dhe institucionalizimi i procesit të matjes së performancës për të gjitha bashkitë e vendit. Puna ka nisur me konsolidimin e strukturave përgjegjëse, në nivel vendor, si dhe me përgatitjen e një pakete metodologjike të standardizuar që do të mundësonte matje të krahasueshme dhe të verifikueshme për secilin tregues të performancës.

Në fillim të vitit, grupi teknik i GNP-së ka punuar intensivisht për rishikimin e treguesve të performancës, duke analizuar sfidat e një viti më parë dhe duke konsultuar një gamë të gjerë aktorësh sektorialë, përfshirë ministrinë e linjës, institucionet statistikore, organizatat ndërkombëtare dhe. Ky proces konsultimesh ka qenë i rëndësishëm për të harmonizuar metodologjinë me burimet administrative, standardet ligjore dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e monitorimit të performancës vendore.

Një moment i rëndësishëm ka qenë finalizimi i paketës prej **52 treguesish të performancës**, të strukturuar në tre fusha kryesore - **financat vendore, shërbimet vendore dhe mirëqeverisja**. U zhvillua Manuali për Sigurimin Cilësisë së të Dhënave, i cila përmban “pasaportën e të dhënës”, që shpjegon definicionin, formulën e llogaritjes dhe burimin e informacionit, në ndihmë të bashkisë. Paralelisht, u krijua instrumenti digjital i raportimit, “Google Form” dhe formati ndihmës në “Excel”, duke dhënë një sistem të qartë të mbledhjes dhe verifikimit të të dhënave.

Një pjesë e rëndësishme e punës ka qenë ngritja e kapaciteteve vendore. Për këtë arsye, AMVV dhe projekti BtF organizuan **5 trajnime rajonale** për të gjitha bashkitë e vendit, nga ku morën pjesë mbi 300 punonjës të Njësive të Performancës ose stafi i specializuar në fusha përkatëse në bashki. Trajnimet u fokusuan në kuptimin e të dhënës, mënyrën e plotësimit të instrumenteve të raportimit, përdorimin e burimeve administrative, si dhe mbi kërkesat e verifikimit për secilin të dhënë.

Pas periudhës së trajnimeve, AMVV zbatoi **një plan shërbimesh në terren për mbështetje teknike** dhe monitorim të procesit për qarqet e vendit (Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë, Vlorë), duke përcjellë dokumentacion mbështetës për sektorët e ndryshëm dhe duke komunikuar vazhdimisht me bashkitë që hasnin vështirësi, për çdo sqarim metodologjik.

Në fazën pasardhëse, u zhvillua procesi i mbledhjes së të dhënave nga bashkitë. Mbledhja u krye brenda afateve zyrtare të përcaktuara në Udhëzimin e Përbashkët, duke përfshirë dorëzimin si në format elektronik, ashtu edhe në formë të nënshkruar zyrtarisht. Pas mbledhjes së të dhënave, procesi vazhdoi me verifikimin e plotë të tyre, duke i krahasuar me burime të tjera të mundshme zyrtare si regjistrat administrative, raportet financiare të Ministrisë së Financave dhe të dhënat e INSTAT. Në rastet e inkoherencave, bashkitë janë njoftuar për rivendosjen ose qartësimin e të dhënave. Vetëm pas përfundimit të procesit të verifikimit, të dhënat u konsideruan zyrtare për analizën e performancës së vitit.

Në vijim, ekipi teknik ka përgatitur analizën krahasuese të performancës duke marrë në konsideratë rezultatet e Cens-it 2023 për përditësimin e variablave demografikë dhe duke zhvilluar një analizë të detajuar për secilin tregues. Për këtë fazë janë hartuar tabelat, grafikët, klasifikimet sipas kategorive të bashkive dhe interpretimet përkatëse, të cilat përbëjnë bazën e raportit vjetor të performancës.

Puna gjithashtu ka qenë e lidhur ngushtë me Grantin e Bazuar në Performancë (GBP), pasi SMP ishte një nga kriteret për shpërndarjen e fondeve të GBP sipas peshës specifike të treguesit.

Raporti final u prezantua më 25 nëntor 2025, duke shërbyer si dokument referimi për politikën e qeverisjes vendore dhe gjendet i aksesueshëm në faqen zyrtare¹.




Figura 5. Pjesëmarrja e stafit të bashkive në trajnime

Detaje rreth procesit dhe rezultateve në lidhje me SMP 2024 mund ti aksesoni në faqen zyrtare².

3 Granti i Bazuar në Performancë

Gjatë vitit të kaluar, koncepti i Grantit të Bazuar në Performancë (GBP) ka kaluar nga faza konceptuale në fazën e zbatimit operativ. Në fillim, diskutimet u fokusuan kryesisht në ndërtimin e mekanizmit financiar që synonte stimulimin e bashkive për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike. Kjo përfshinte analizimin e nevojave, dhe përcaktimin e parimeve të para të mekanizmit, pa hyrë ende në elemente të implementimit praktik.

Në vitin 2025 është bërë një avancim i rëndësishëm me vënien në funksion të mekanizmit të GBP-së, në zbatim të **Udhëzimit të Përbashkët nr.01 datë 11.07.2025** të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili përcakton kriteret, procedurat, treguesit e GBP-së dhe rolet institucionale në procesin e akordimit të grantit. Ky grant, i bashkëfinancuar nga Qeveria e Shqipërisë dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), synon të nxisë standardizimin e proceseve të qeverisjes vendore dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Gjatë fazës përgatitore të procesit të Grantit të Bazuar në Performancë, AMVV, në rolin e Sekretariatit Teknik, vijoi procesin e informimit dhe ndërgjegjësimit të bashkive për detyrimet dhe afatet e paraqitjes së dokumentacionit. Në këtë kuadër, u zhvilluan komunikime paraprake zyrtare, u shpërndanë udhëzime teknike mbi afatet e dorëzimit dhe periudhën e miratimit të planeve vendore,

¹ <https://qeverisjavendore.gov.al/ep-content/uploads/2025/11/SMP-2024.pdf>

² Manuali për sigurimin e cilësisë së të dhënave: https://qeverisjavendore.gov.al/ep-content/uploads/2025/07/Manuali-SMP-4-Korrik_Final-AMVV-02.pdf

ndërsa mekanizmi i GBP u integrua në të gjitha aktivitetet e asistencës teknike dhe trajnimeve të zhvilluara në terren për Sistemin e Matjes së Performancës.

Të gjitha materialet shoqëruese dhe udhëzimet u publikuan në faqen zyrtare të AMVV³, duke garantuar transparencë dhe akses të barabartë për të gjitha bashkitë.

Gjatë periudhës së aplikimit, AMVV administroi dhe shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë, duke regjistruar çdo aplikim me datë dhe orë si në format elektronik ashtu edhe në atë fizik. Dokumentacioni i paraqitur iu nënshtrua një verifikimi të hollësishëm për të siguruar plotësinë e tij, ndërsa bashkitë u njoftuan për çdo mangësi teknike të konstatuar, si rezultat i volumit të lartë të dokumentacionit dhe larmisë së formateve të dorëzimit.

Në vijim, AMVV kreu vlerësimin teknik për secilin tregues, në përputhje me kërkesat e Aneksit 2 të Udhëzimit të Përbashkët. Për çdo bashki u përgatitën dosje të strukturuar dhe individualizuara, duke siguruar **një proces të paanshëm, transparent dhe të dokumentuar me rigorozitet**. Si pjesë e përgjegjësi të Sekretariatit Teknik, AMVV mbështeti plotësisht Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve (KVA), duke koordinuar organizimin e të gjitha mbledhjeve, përgatitur materialet dhe memot shpjeguese, si dhe duke dokumentuar procesverbalet dhe vendimmarrjen e komisionit. Pas përfundimit të vlerësimit, rezultatet u publikuan në faqen zyrtare të Agjencisë⁴ dhe u komunikuan bashkive përmes shkresave dhe e-mailit zyrtar.

Në përputhje me procedurat e parashikuara, AMVV administroi procesin e ankesave duke regjistruar të gjitha pretendimet e ngritura brenda afatit ligjor dhe duke përgatitur dokumentacionin mbështetës për shqyrtim nga KVA. Vendimet përfundimtare të komisionit lidhur me ankesat u dokumentuan dhe u njoftuan zyrtarisht bashkitë.

Me përfundimin e të gjithë ciklit të vlerësimit, AMVV përgatiti listën përfundimtare të shpërndarjes së fondit, bazuar në vendimet e miratuara nga KVA, dhe ia përcolli Ministrisë së Financave dhe partnerëve, së bashku me të gjitha vendimet dhe dokumentacionin shoqërues. Në çdo fazë të procesit, AMVV siguroi që dokumentacioni, të dhënat dhe vendimmarrja të ishin plotësisht në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Përbashkët dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Treguesit në kuadër të GBP

- ⇒ Treguesit e SMP 2024;
- ⇒ Treguesit Financiarë:
 - Treguesi i detyrimeve të prapambetura;
 - Treguesi i realizimit të buxhetit;
 - Treguesi i taksës mbi pasurinë e paluajtshme.

⇒ Treguesit për Planet Vendore:

- Plani Vendor i Mbarështimit të Pyjeve;
- Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve;
- Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar;
- Plani Vendor Social;
- Plani Vendor i Integritetit;
- Plani Vendor i Barazisë Gjimore.

³ <https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/granti-i-bazuar-ne-performance/>

⁴ <https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/granti-i-bazuar-ne-performance/rreth-grantit/>

4 Projekti “Open Dat’Alb”

Gjatë vitit raportues, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ka vijuar zbatimin e projektit **Open Dat’Alb**, një iniciativë strategjike e mbështetur financiarisht nga Ambasada Franceze në Tiranë, në kuadër të programit “Fonds Équipe France” dhe e zbatuar operacionalisht nga grupi Spallian. Ky projekt synon forcimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore për hartimin dhe vlerësimin e politikave publike të bazuara në të dhëna, rritjen e transparencës, si dhe harmonizimin e praktikave të bashkive shqiptare me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e të dhënave të hapura.

Gjatë vitit janë kryer disa veprimtari të rëndësishme ndërinstitucionale, përfshirë vizitën e dytë të ekipit Spallian në Shqipëri, të zhvilluar në datat **28 tetor – 1 nëntor 2025**. Programi i vizitës përfshiu takime pune me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV, Institutin e Statistikave (INSTAT), me bashkitë pilote të projektit: **Berat, Durrës, Korçë dhe Elbasan**. Qëllimi kryesor i këtij cikli takimesh ishte rishikimi i progresit të deritanishëm, vlerësimi i demonstrimeve të paraqitura nga Spallian mbi analizën e të dhënave të nivelit bashkiak, si dhe diskutimi mbi përdorimet e propozuara të të dhënave për mbështetje të vendimmarrjes.

Në takimin me Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV-në u analizua ecuria e projektit, katalogu i të dhënave të mbledhura deri më tani, shkalla e pastrimit dhe transformimit të informacionit. Takimi me INSTAT, i zhvilluar në nivel drejtues, kishte si qëllim koordinimin ndërinstitucional, shkëmbimin e informacionit mbi mjetet analitike, që INSTAT po zhvillon për bashkitë, si dhe diskutimin e mundësisë së aksesit në të dhënat e Census 2023 për përdorim në platformën Open Dat’Al, duke siguruar përputhshmërinë dhe shmangie të mbivendosjeve mes iniciativave.

Takimet në bashki u përqendruan në prezantimin e projektit për drejtuesit vendorë, identifikimin e personave përgjegjës për menaxhimin e të dhënave, vlerësimin e disponueshmërisë së të dhënave në nivel lokal dhe mbledhjen e rasteve të përdorimit që do të orientonin zhvillimin e mëtejshëm të platformës. Në bashkitë Berat, Durrës, Korçë dhe Elbasan u realizuan diskutime të thelluara mbi kategoritë e të dhënave, standardizimin e formateve dhe mundësinë e krijimit të partneriteteve të bashkëpunimeve të decentralizuara ndërmjet bashkive shqiptare dhe atyre franceze.

Gjatë gjithë këtij procesi, prania fizike e ekspertëve të Spallian në terren - përfshirë koordinatoren lokal, ekspertët e të dhënave, si dhe menaxherët teknikë të projektit - ka mundësuar mbledhjen e të dhënave burimore, kryerjen e analizave paraprake, si dhe ndërveprim të vazhdueshëm me strukturat vendore. AMVV ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin institucional, garantimin e cilësisë së të dhënave dhe sigurimin e koherencës së projektit me iniciativat kombëtare në fushën e qeverisjes me të dhëna.

Si rezultat i këtyre ndërveprimeve, gjatë vitit 2025 është arritur avancimi i fazave të para të projektit, përfshirë: krijimin e bazës fillestare të të dhënave të nivelit lokal dhe kombëtar, testimin e demonstruesve teknikë për vizualizimin dhe analizën e të dhënave, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe përgatitjen e kushteve për ndërtimin e mjetit digjital të projektit Open Dat’Alb.

KAPITULLI IV: DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE

Gjatë vitit 2025 u shënuan zhvillime të rëndësishme në procesin e integrimit evropian, veçanërisht me hapjen e negociatave për **Grupkapitullin 5 më 17 nëntor 2025**, ku përfshihet edhe **Kapitulli 22**, i lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin lokal territorial, ekonomik dhe social. Në këtë kuadër, **Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor** ka ushtruar funksionin e **Negociatorit për Kapitullin 22**, ndërsa **AMVV**, përmes **Drejtorisë së Integrimit Evropian**, e cila ka vepruar si **Sekretariat Teknik**, duke koordinuar punën ndërinstytucionale dhe duke transmetuar informacionet relevante tek **Njësitë e Integrimit Evropian** në bashki. Në këtë kuadër janë organizuar pesë mbledhje zyrtare me pjesëmarrjen e institucioneve përgjegjëse të sektorëve që mbulojnë politikat territoriale, zhvillimin rajonal, financat publike, planifikimin e fondeve, decentralizimin etj

Sekretariati Teknik, në bashkëpunim me **Projektin e Asistencës Teknike për Kapitullin 22** të financuar nga BE, përgatiti dhe dorëzoi tek **Zyra e Kryenegociatorit** në **gusht 2025 Pozicionin Negociues të Shqipërisë**. Më pas Bashkimi Evropian hapi negociatat për **Grupkapitullin V** për Shqipërinë ku bën pjesë edhe Kapitulli 22. Pas hapjes zyrtare të negociatave u komunikua **Pozicioni i Përbashkët BE–Shqipëri**. Mbi këtë bazë filloi puna për përgatitjen e **planit të masave** nga Shqipëria për përmbushjen e **piketave mbyllëse** të kapitullit.

Një pjesë tjetër e rëndësishme e punës së Agjencisë ka qenë **informimi, përgatitja dhe rritja e kapaciteteve** të bashkive për procesin e integrimit. Në këtë kuadër janë organizuar trajnime dhe asistencë të stafëve të Njësitë të Integrimit Evropian për rritjen e kapaciteteve të tyre në **përfitimin dhe menaxhimin e saktë të fondeve të BE-së**.

Gjatë vitit janë organizuar gjithashtu dy konferenca: Konferenca “**Ngjytja në një nivel më të lartë: Roli i Bashkive Shqiptare në Integrimin Evropian**” dhe Konferenca bilaterale e **Komitetit Konsultativ të Përbashkët** midis **Komitetit të Rajoneve të BE-së** dhe bashkive shqiptare.

1 Zhvillimet lidhur me Kapitullin 22

Në vijim të hapjes së negociatave për **Grupkapitullin 5 më 17 nëntor 2025**, ku bën pjesë edhe **Kapitulli 22**, **Komisioni Evropian** i përcolli palës shqiptare **Pozicionin e Përbashkët**, dokument në të cilin përcaktohen orientimet kryesore dhe **piketat mbyllëse** për kapitujt përkatës, përfshirë Kapitullin 22.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që përcaktohen nga ky pozicion negociues, në cilësinë e **Sekretariatit Teknik të Kapitullit 22** dhe me asistencën e **Projektit të Asistencës Teknike për Kapitullin 22**, është hartuar **plani i masave** për përmbushjen e piketave mbyllëse të Kapitullit 22, duke adresuar aspektet kryesore që lidhen me përgatitjen institucionale dhe koordinimin ndërinstytucional në këtë fushë.

Në rolin e Sekretariatit Teknik të Kapitullit 22, **AMVV** ka koordinuar përgatitjet dhe raportimet ndërinstytucionale, duke siguruar përfshirjen e pushtetit vendor dhe harmonizimin e kontributeve të palëve të ndryshme.

Gjithashtu në zbatim të **Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 29.5.2019**, “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstytucionale të punës për integrimin evropian”, **GNPIE e Kapitullit 22** ka zhvilluar gjatë vitit 2025 **pesë mbledhje**, me qëllim koordinimin dhe ndjekjen e përmbushjes së detyrimeve të këtij kapitulli. Në këto mbledhje marrin pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale.

2 Informimi, përgatitja dhe fuqizimi i drejtpërdrejtë i bashkive mbi procesin e integritit evropian

Për të rritur informimin dhe njohjen mbi rolin e pushtetit vendor në politikën e kohezionit, gjatë vitit 2025 u organizuan konferenca dhe aktivitete me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar:

a. Trajnim përmes instrumentit TAIEX për bashkitë. Në datat **7–8 prill 2025** në **Shkodër** dhe **9–10 prill 2025** në **Vlorë**, Drejtoria e Integritit Evropian dhe Projekteve, **AMVV**, në bashkëpunim me instrumentin e asistencës teknike **TAIEX** të Komisionit Evropian, organizoi **dy trajnime dy-ditore** me temë “Roli i Bashkive Shqiptare në Procesin e Integritit në BE”. Trajnimet u fokusuan në: rolin e bashkive në politikën e kohezionit; hartimin e Planeve Lokale të Zhvillimit dhe krijimin e një “Project Pipeline”; promovimin e praktikave të mira nga **Polonia, Rumania dhe Estonia**; si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional për koordinim të suksesshëm të projekteve të financuara nga fondet e BE-së. Në trajnime morën pjesë stafet e Njësive të Integritit Evropian nga **58 bashki** (25 bashki në Shkodër dhe 33 bashki në Vlorë).

b. Trajnim “Feasibility Studies of Public Infrastructure Projects under Cohesion Policy”. Në datat **16 dhe 17 korrik 2025**, Projekti i Asistencës Teknike për Kapitullin 22 organizoi trajnim mbi kërkesat për investimet publike të financuara nga fondet e kohezionit (impakti mjedisor, vlerësimi financiar dhe ekonomik, etj.). Pjesëmarrës ishin Njësitë e Integritit të bashkive kryesisht të mëdha si **Shkodra, Berati, Lezha** etj., si dhe **inxhinierë dhe arkitektë** të administratës lokale.

c. Konferenca kombëtare: “Ngjitja në një nivel më të lartë: Roli i Bashkive Shqiptare në Integrimin Evropian”. Më **13 nëntor 2025**, në kuadër të projektit **EU4GoodGovernance (Komponenti III)**, u zhvillua konferenca kombëtare me temë “Ngjitja në një nivel më të lartë: Roli i Bashkive Shqiptare në Integrimin Evropian”, me fokus rolin dhe sfidat e pushtetit vendor në procesin e integritit. Diskutimet u organizuan në **tre panele**: (1) bazat e qeverisjes vendore dhe **Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore**; (2) marrëdhëniet fiskale dhe autonomia fiskale e bashkive; (3) roli i bashkive në zhvillimin dhe kohezionin e territorit. Morën pjesë **të gjithë kryetarët e 61 bashkive** dhe stafi i **NJIE nga 8 bashkitë pilote**; konferenca shërbeu si platformë dialogu me homologë nga vendet e BE-së dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes institucionale në kuadër të negociatave dhe anëtarësimit.

d. Konferenca bilaterale e Komitetit Konsultativ të Përbashkët (JCC). Më 4 dhjetor 2025, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe AMVV organizuan Konferencën bilaterale të JCC midis **Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian dhe Bashkive të Shqipërisë**, aktiviteti i parë i këtij lloji në Shqipëri. Diskutimet u fokusuan në: **decentralizimin fiskal, qëndrueshmërinë financiare të bashkive dhe mekanizmat për përfshirjen efektive** të pushtetit vendor në politikën e kohezionit; duke shërbyer si forum shkëmbimi përvojash dhe forcimi të bashkëpunimit institucional.

3 Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të Njesive të Integritimit Evropian nëpërmjet trajnimeve

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve administrative të bashkive, gjatë vitit 2025 Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, AMVV, ka realizuar 6 trajnime teknike online për Njësitë e Integritimit Evropian të realizuara nga stafi i Drejtorisë së Integritimit Evropian dhe Projekteve, AMVV. Trajnimet janë fokusuar në programe dhe thirrje konkrete të Bashkimit Evropian, duke përfshirë CERV, ERASMUS+ dhe URBACT IV ku bashkitë shqiptare janë të pranura të aplikojnë dhe janë aplikues të synuar.

	Data	Tema e trajnimit	Programi	Bashkitë pjesëmarrëse	Stafi i trajnuar
1	11 shkurt 2025	"Rrjeti i Qyteteve"	CERV	24	42
2	28 shkurt 2025	"Rinia" dhe "Sporti"	ERASMUS+	8	8
3	22 prill 2025	"Angazhimi dhe Pjesëmarrja e Qytetarëve" dhe "Të Drejtat e Fëmijëve dhe Pjesëmarrja e Fëmijëve"	CERV	21	31
4	5 maj 2025	"Parandalimi dhe Luftimi i Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës ndaj Fëmijëve"	CERV	19	30
5	11 qershor 2025	Rrjetet e Transferimit	URBACT IV	12	14
6	1 shtator 2025	"Binjakëzimi i Qyteteve"	CERV	9	10
7	Totali				135

Tabela 1. Trajnimet e ofruara për periudhën janar – dhjetor 2025

Gjatë vitit 2025 Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, AMVV, ka ofruar asistencë të drejtpërdrejtë dhe të personalizuar për 13 bashki (Bashkitë Kamëz, Klos, Dibër, Elbasan, Dropull, Berat, Pogradec, Pukë, Peqin, Divjakë, Gjirokastrë, Bulqizë dhe Durrës) në procesin e menaxhimit të projekteve të financuara nga BE-ja, duke adresuar çështje procedurale, financiare dhe administrative. Asistenca ka përfshirë mbështetje mbi rregullat e PRAG, kërkesat për bashkëfinancim, regjistrimin e projekteve në Ministrinë e Financave dhe hapjen e llogarive në Thesar, si dhe zgjidhjen e problematikave të lidhura me TVSH-në dhe përdorimin e portaleve zyrtare të BE-së Funding & Tenders dhe PADOR.

Gjatë vitit 2025, janë asistuar 6 bashki (Bashkitë Dropull, Libohovë, Maliq, Cërrik, Belsh dhe Bulqizë), të cilat kanë kërkuar mbështetje nga AMVV për shkrim projektsh dhe nga asistenca e ofruar janë fituar 5 projekte.

Në funksion të rritjes së aksesit të bashkive në financimet e Bashkimit Evropian, Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, AMVV, ka identifikuar, analizuar dhe përpunuar informacion mbi 30 thirrje të hapura nga programe të ndryshme evropiane financimi. Për secilën thirrje janë përgatitur skeda informative të strukturuar, të cilat janë përcjellë në mënyrë zyrtare tek Njësitë e Integritimit Evropian të bashkive. Ky proces ka shërbyer si instrument praktik për orientimin e bashkive drejt thirrjeve më të përshtatshme dhe për përmirësimin e cilësisë së aplikimeve të tyre.

4 Realizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me projektet e asistencës teknike të BE-së në fushën e Integritimit Evropian

Gjatë vitit 2025, AMVV thelloi bashkëpunimin strategjik me projektet e asistencës teknike të BE-së, për të mbështetur bashkitë dhe forcuar kapacitetet institucionale në procesin e integritimit. Bashkëpunimet kryesore përfshijnë Asistencën Teknike për Kapitullin 22, EU4GoodGovernance dhe ReLoD3.

4.1 Bashkëpunimi me Projektin EU4GoodGovernance

Në 2025, ky projekt mbështeti AMVV në bashkëorganizimin e aktiviteteve, si më poshtë:

Krijimi i një udhërrëfyesi praktik për standardet e komunikimit gjatë proceseve të konsultimit publik në nivel vendor. Ky mjet praktik synon të përmirësojë transparencën, përfshirjen dhe efektivitetin e dialogut të bashkive me qytetarët. Prezantimi i parë u mbajt më 26 qershor 2025 në Bashkinë Shkodër, me përfaqësues nga 13 bashki të veriut. Dy prezantime të tjera janë të planifikuara për t'u zhvilluar gjatë vitit 2026.

Java e Evropës 2025: Mbështetje për organizimin e aktiviteteve në 10 bashki për të promovuar vlerat evropiane.

Konferencë kombëtare: Më 13 nëntor 2025, u bashkë-organizua konferenca “Ngjitja në një nivel më të lartë: Roli i Bashkive Shqiptare në Integritimin Evropian”, me pjesëmarrjen e 61 kryetarëve të bashkive dhe përfaqësuesve të NJIE-ve.

4.2 Bashkëpunimi me Programin ReLoaD 3

Programi “Regional Program on Local Democracy in the Western Balkans 3” (ReLoaD 3) është një program rajonal i Bashkimit Evropian, i implementuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me qëllim kryesor përforcimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë.

Programi vepron në 22 bashki në Shqipëri, me 7 bashki partnere në fazën aktuale: Kavajë, Lezhë, Shkodër, Mirditë, Divjakë, Berat dhe Vlorë. Në tetor 2025, 28 staf të qeverisjes vendore u trajnuan në Shkodër dhe Berat mbi metodologjinë LOD dhe menaxhimin e ciklit të projektit. Nëpërmjet aktivitetit të vazhdueshëm të informimit dhe orientimit, AMVV ndihmoi bashkitë shqiptare të njihnin me mënyrën e funksionimit të ReLoaD 3, të identifikonin prioritetet e tyre lokale të përshtatshme për këtë program dhe të përgatiteshin për të hartuar thirrje cilësore dhe për të menaxhuar me sukses projekte në bashkëpunim me shoqërinë civile. Ky bashkëpunim rajonal ndihmon në ndërtimin e një modeli të qëndrueshëm për zhvillimin e bazuar në komunitet, në përputhje të plotë me rrugën e integrimit evropian.

KAPITULLI V: MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET AMVV DHE UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Qendrës për Kërkim-Zhvillim Rajonal dhe Vendor pranë UT-së, Nr. 563 Prot., datë 3.10.2024.

Tematika I – Strategjia për zhvillimin ekonomik rajonal të qëndrueshëm për Qarkun Elbasan përfshiu realizimin e një studimi dhe analize të detajuar të situatës aktuale në qark, identifikimin e zonave me potencial ekonomik të pashfrytëzuar, hartimin e planit për zhvillimin rural me synim uljen e pabarazisë social-ekonomike ndërmjet qendrës së qarkut dhe zonave rurale, studimin dhe vlerësimin e aseteve vendore të secilës bashki, si dhe përgatitjen e planeve zhvillimore ekonomike 5-vjeçare të çdo bashkie, me parashikimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Procesi i hartimit është shoqëruar nga grupi i ekspertëve dhe AMVV me vizita në terren dhe takime me përfaqësues lokalë, përfshirë ish-Kombinatit Metalurgjik në Elbasan, fabrika riciklimi dhe prodhimi, si dhe biznese agroturizmi në Cërrik, me qëllim evidentimin konkret të potencialeve industrial, bujqësor dhe turistik.

Nga analiza e përmbajtjes rezulton se për të gjitha bashkitë e Qarkut Elbasan: “Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Prrenjas, Librazhd dhe Peqin” janë përmbushur elementët e kërkuar sipas specifikimeve teknike. Studimi i situatës aktuale përfshin treguesit mbi papunësinë, demografinë, shpërndarjen e komuniteteve, sektorët e zhvillimit ekonomik, mirëqenien sociale dhe ekonomike, si dhe burimet natyrore, me disa raste ku analiza e papunësisë nuk shoqërohet me të dhëna numerike të plota.

Gjithashtu, është realizuar identifikimi i zonave me potencial ekonomik të pazhvilluar, përfshirë resurset e kapitalit natyror dhe destinacionet turistike të panjohura, si dhe është hartuar plan i përgjithshëm operacional me prioritetet dhe objektiva për zhvillimin koheziv të territorit. Janë përfshirë masa dhe politika për zhvillimin ekonomik në bujqësi dhe agro-turizëm, aneksi i investimeve, si dhe studimi dhe vlerësimi i aseteve vendore.

Në përfundim, janë hartuar **plane zhvillimore ekonomike 5-vjeçare të bashkive të qarkut Elbasan** duke përmbushur kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

Tematika II – Hartëzimi i vendimeve TIP të këshillave bashkiakë për secilin funksion të NJVV-ve konsistoi në përzgjedhjen e vendimeve dhe urdhrave tip sipas funksioneve të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015. Nga vlerësimi i kryer, AMVV identifikoi se në vendimet dhe urdhrat tip është respektuar teknika legjislative, duke reflektuar kur është e aplikueshme, edhe vendime të organeve gjyqësore apo rekomandime të organeve kompetente, përfshirë KLSH-në dhe KMSHC-në. Në total janë përzgjedhur **43 Vendime TIP dhe 6 Urdhra TIP** duke ofruar një instrument praktik referimi për përmirësimin e funksionimit të NJVV-ve dhe për forcimin e praktikës së unifikuar administrative dhe ligjore. Në tërësi, AMVV vlerësoi se materialet e paraqitura përmbushin kushtet sipas specifikimeve teknike.

Tematika III – Njohja me historikun e zhvillimit të qeverisjes vendore në RSH për periudhën 1912– në vazhdim konsistoi në trajtimin e evolucionit ligjor, politik dhe organizativ të pushtetit vendor në Shqipëri, marrëdhëniet me pushtetin qendror dhe procesin e decentralizimit, duke evidentuar problematikat dhe ndikimet e secilës periudhë historike në zhvillimin institucional të qeverisjes vendore. Në këtë kuadër, u konstatua se materiali përfshin një analizë të plotë historike dhe ligjore që nga **shpallja e Pavarësisë (1912)** dhe në vijim, duke trajtuar në mënyrë të veçantë zhvillimet institucionale dhe politike të periudhave **1925–1939** dhe **1946–1990**. AMVV evidentoi se analiza adreson marrëdhëniet ndërmjet pushtetit vendor dhe atij qendror, ndikimet e ideologjisë shtetërore, si dhe transformimet administrative e territoriale në etapa të ndryshme historike. Gjithashtu, është realizuar identifikimi i problematikave karakteristike të secilës periudhë, përfshirë tranzicionin institucional pas vitit 1912, centralizimin në periudhat e mëvonshme dhe kufizimet në autonominë vendore duke rezultuar në përmbushjen e kërkesave sipas specifikimeve teknike.

Në vijim, janë analizuar objektivat, ndikimet dhe rezultatet e secilës periudhë në funksion të zhvillimit të qeverisjes vendore dhe të procesit të decentralizimit, duke ofruar një bazë analitike për kuptimin e sfidave bashkëkohore dhe reflektim në politikat aktuale.